

I FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

PRODRENITIDI

Tretësirë për injeksion – 50 mg / 5 ml
(Ranitidinë klorhidrat)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

- Çfarë është Prodrrenitidi dhe përse përdoret
- Përpara se të merrni Prodrrenitidi
- Si ta merrni Prodrrenitidi
- Efekte anësore të mundshme
- Si ta ruani Prodrrenitidi
- Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË PRODRENITIDI DHE PËRSE PËRDORET

Prodrrenitidi përmban lëndën vepruese ranitidinë klorhidrat. Ranitidina është një antagonist i receptorëve H2 të histaminës që ndihmon në mjekimin e ulçerës gastrike dhe duodenale duke frenuar sekretimin e acidit klorhidrik si rezultat i bllokimit të receptorëve H2. Ranitidina, cimetidina si dhe barna të tjera të këtij grupi, përmirësojnë ezofagitin peptik dhe në doza të larta pakësojnë prodhimin e acidit në sindromin Zollinger - Ellison.

Prodrrenitidi indikohet:

- në trajtimin e ulçerës gastrike beninje dhe duodenale duke përfshirë edhe atë që shkaktohet nga agjentët antiinflamatorë josteroidë;
- në sëmundjen e refluksit gastro-ezofageal;
- në sindromin Zollinger-Ellison;
- në ulçeracionet e shkaktuara nga stres;
- në profilaksinë e hemorragjisë që përsëritet herë pas here tek të sëmurët me ulçer peptike hemorragjike.

2. PËRPARA SE TË MERRNI PRODRENITIDI

Mos merrni Prodrrenitidi:

- nëse keni mbindjeshmëri ndaj ranitidinës klorhidrat ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të këtij bari.

Tregoni kujdes të veçantë me Prodrrenitidi

Ranitidina përthithet shumë mirë nga organizmi. Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni Prodrrenitidi.

- Ky bar mund të maskojë simptomat që shoqërojnë kancerin e stomakut, kështu që duhet përjashtuar ekzistenca e kancerit malinj para fillimit të mjekimit me Prodrrenitidi.
- Duhet të përdoret me kujdes tek të sëmurët me dëmtim të funksionit renal ose insuficiencë renale, pasi ranitidina jashtëqitet me anë të veshkave, kështu që nivelet plazmatike të saj rriten tek këta të sëmurë dhe për këtë arsye doza duhet të jetë 25 mg / ditë.
- Ranitidina jashtëqitet edhe me anë të qumështit të gjirit; mund të përdoret gjatë shtatzënisë dhe ushqyerjes me gjí vetëm kur është e domosdoshme.

Marrja e barnave të tjerë

Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjerë mund të ndikojë ose të ndikohet nga Prodrrenitidi. Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjerë, përfshirë ato të marrë pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Prodrrenitidi në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit.

Antagonistët e receptorëve H2 zgjasin metabolizmin oksidues të barnave që veprojnë në mëlçi duke u lidhur me citokromin mikrozomal P450.

Ajo nuk duhet përdorur në të sëmurët e stabilizuar me varfarinë, fenitoinë dhe teofilinë (aminofilinë). Antagonistët e receptorëve H2 kanë një ndërveprim edhe me barna të tjerë, por me një rëndësi klinike të vogël, si me: analgjezikët, anksiolitikët, hipnotikët, antidepresivët, antiaritmikët, antibakterialët, antidiabetikët, antiepileptikët, antihelmintikët, antimalarikët, antipsikotikët, etj.

Marrja e Prodrrenitidi me ushqim dhe pije

Prodrrenitidi merret me injeksion kështu që nuk ndikon.

Shtatzënia

Kërkoni këshillën e farmacistit ose të mjekut përpara se të merrni këtë bar. Mund të përdoret gjatë shtatzënisë vetëm kur është e domosdoshme.

Ushqimi me gjí

Ranitidina kalon në qumështin e gjirit dhe mund të përdoret gjatë ushqyerjes me gjí vetëm kur është e domosdoshme.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Ky bar mund të japë turbullime të shikimit, kështu që duhet të kini kujdes në drejtimin e automjetit dhe përdorimin e makinerive.

3. SI TA MERRNI PRODRENITIDI

Gjithmonë merreni Prodrrenitidi sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin. Në qoftë se ndjeni që efektet e Prodrrenitidi janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.

Të rriturit:

Prodrrenitidi merret me injeksion në muskul, me injeksion në venë, dhe si perfuzion i vazhdueshëm. Prodrrenitidi merret me injeksion në muskul 50 mg, çdo 6 - 8 orë.

Prodrrenitidi në trajtë tretësire për injeksion duhet të injektohet ngadalë në vena (të paktën për 2 minuta) me një dozë prej 50 mg ranitidinë pas hollimit në 20 ml tretësirë të injektueshme klorur natriumi 0.9% ose me tretësira të tjera të pranueshme deri në një përqëndrim 2.5 mg / ml.

Perfuzion i vazhdueshëm në venë: Tretësira 50 mg. Prodrrenitidi hollohet në tretësirën për perfuzion të glukozës 5% ose në një tretësirë tjetër të pranueshme dhe merret për rreth 2 orë (25 mg ranitidinë / orë).

Për pacientët me sindromin Zollinger – Ellison Prodrrenitidi hollohet në tretësirën për perfuzion të glukozës 5% ose në një tretësirë tjetër të pranueshme me një përqëndrim jo më të madh se 2.5 mg / ml, duke filluar marrja në vlerat 1 mg / kg për orë. Në rast se pas 4 orësh pacienti shfaq shqetësime dhe rritet sasia e acidit gastrik në vlerën 10 mEq / orë, doza duhet të rritet me 0.5 mg / kg për çdo orë. Doza do të rritet në 2.5 mg / kg / orë dhe sasia e infuzionit të përdorur do të jetë aq e madhe sa të merret 220 mg / orë.

Në të sëmurët me dëmtim të funksionit të veshkave ndodh akumulimi i ranitidinës, e cila shkakton rritjen e përqendrimeve plazmatike të saj, prandaj këshillohet që në këta të sëmurë ranitidina të jepet me një dozë prej 25 mg.

Në qoftë se keni marrë më shumë Prodrrenitidi

Në qoftë se keni marrë më shumë Prodrrenitidi se sasia që duhet të merrni, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren. Megjithatë nuk janë vënë re simptoma të mbidozimit gjatë marrjes së injeksionit të ranitidinës.

Në qoftë se harroni të merrni Prodrrenitidi

Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj. Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a). Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij bari, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjithë barnat e tjerë, Prodrrenitidi mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston.

Pjesa më e madhe e efekteve anësore janë të lidhura me dozën dhe zhduken kur doza reduktohet ose trajtimi ndërpritet. Disa efekte anësore mund të ndodhin në fillim të trajtimit dhe zhduken në mënyrë spontane me vazhdimin e mjekimit. Efektet anësore të Prodrrenitidi janë efekte të rralla, të përkohshme dhe të prapësueshme. Të tilla janë vërejtur në funksionimin e mëlçisë, leukopeni, trombocitopeni, agranulocitozë ose pancitopeni, ndonjëherë hipoplazi ose aplazi e palcës si dhe diarree, çrregullime të tjera gastrointestinale, lodhje. Raste të rralla janë ato të mbindjeshmërisë, temperaturës dhe çrregullimeve kardio-vaskulare përfshirë: bradikardi, bllok atrioventrikular, arrest

kardiak. Efekte të tjera të rralla janë: dhimbje koke (edhe të forta), marrje mendsh, turbullime të shikimit, konfuzion mendor dhe halucinacione, kryesisht tek pacientët e moshuar, ata në gjendje të rëndë ose tek pacientët me dëmtime renale dhe hepatike. Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI PRODRENITIDI

Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni Prodrrenitidi pas datës së skadimit e cila është e shënuar në paketim. Mos e ruani mbi 25°C!
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Prodrrenitidi – tretësirë për injeksion 50 mg / 5 ml

Lënda vepruese është ranitidinë klorhidrat. Çdo ampulë 5 ml përmban ranitidinë klorhidrat që është ekuivalent me 50 mg ranitidinë bazë. **Përbërësit e tjerë:** hidroksid natriumi, ujë për injeksion.

Përmbytja e paketimit

Kuti me 10 ampula me nga 5 ml.
Kuti me 100 ampula me nga 5 ml (për përdorim spitalor).

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:



Sipas recetës së mjekut.



Përmbajtja. **!** Kujdes.



Tretësirë për injeksion, (për perfuzion).

Mbajtësi i autorizimit për tregtim (MAT) dhe prodhuesi:



PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00 355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Shtator 2013.

